



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 224/6 prot.

Datë 03.02.2026

V E N D I M
Nr. 185/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së OE “G .A .C” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë*”, me Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “G & M CONSTRUCTION 07” SHPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “HTM” SHPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “NDERTUESI 2000” SHPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “MANE/S” SHPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “G .A .C” Shpk me NIPT L61619031A dhe adresë: Rruga Pylla e Zeqirit, Nr Pas 211/158, ZK 1605, Sauk, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) me adresë: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9

Subjekt i interesuar:

OE “G & M CONSTRUCTION 07” SHPK me NUIS M21313027A, dhe me adresë Tiranë, Rruga Irfan Tomini Pasuria Nr 7/562-N12 Zona Kadastrale 8260.

OE “HTM” SHPK me NUIS K97006004D, dhe me adresë Shkoder, , Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44.

OE “NDERTUESI 2000” SHPK me NUIS J96409033R, dhe me adresë Bushat, Shkodër.

OE “MANE/S” SHPK me NUIS J64103865K, dhe me adresë Vlorë Sarandë, SARANDE, Lagja 2, P 46.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik animues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.12.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë”, me Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt "Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull", me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

II.2. Në datën 05.01.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 15.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.OE “G.C.A” sh.p.k.	9,753,348 Lekë pa TVSH I skualifikuar
2.OE “HTM” sh.p.k	9,979,249.40 Lekë pa TVSH I kualifikuar
3.OE “MANE/S” sh.p.k	10,928,892 Lekë pa TVSH I kualifikuar
4.OE “Ndertuesi 2000” sh.p.k	11,338, Lekë pa TVSH I kualifikuar
5.OE “G & M Construction 07” sh.p.k	11,613,449.4 Lekë pa TVSH I kualifikuar

II.4. Në datën 22.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur OE “HTM” sh.p.k, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 07, datë 26.01.2026.

II.5. Në datën 26.01.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6274, si dhe nr. protokolli 224/2026 datë 26.01.2026 e operatorit ekonomik “G .A .C” Shpk, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë*”, me Nr. Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt "Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G .A .C” Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G & M CONSTRUCTION 07” Shpk, operatori ekonomik “HTM” SHPK, operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK dhe operatori ekonomik “MANE/S” SHPK, të cilët pretendohet se, nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim, sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.5.1. Në datën 27.01.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar me shërbim postar formualri i ankesës me nr. 224/1 prot., datë 27.01.2026 e operatorit ekonomik “G .A .C” Shpk, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë*”, me Nr. Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt "Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), me të njëjtat pretendime.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 224/2 prot., datë 27.01.2026, lidhur me kundërshtimi e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G .A .C” Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G & M CONSTRUCTION 07” Shpk, operatori ekonomik “HTM” SHPK, operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK dhe operatori ekonomik “MANE/S” SHPK, të cilët pretendohet se, nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim, sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Njëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 750/3 prot., datë 28.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 224/3 prot., datë 02.02.2026, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK.

Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e ankesës së operatori ekonomik ankimues “G.A.C”, duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]

❖ **Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave arsyeton si më poshtë:**

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në lidhje me pretendimet e mësipërme të OE ankimues, iu referua ankesës së operatorit ekonomik, dokumenteve të tenderit të hartuara nga NJP, si dhe vlerësimit të dokumenteve të tenderit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ku pasi i shqyrtoi ato me imtësi arriti në konkluzionin si më poshtë vijon:

Referuar të Nenit 82, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

Autostrada Tiranë - Durrës, Km 9 , Yrshek, Kashar, Tiranë, Tel +355 4 2225581, Fax +355 4 2225581, info@ost.al, www.ost.al

- ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë." Sipas dispozitave të sipërcituara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, nëse është e nevojshme në kuadër të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur, ka të drejtën të kërkojë sqarim, për të saktësuar personelin e deklaruar për pozicionin e manovratorit, sipas kërkesës së dokumenteve standarte të tenderit.

OE ankimes "G.A.C" sh.p.k., ka ngarkuar si dokument provues kontratën e punës me Nr. 6360 Rep, Nr. 3755 Kol, datë 31.12.2025, me qëllim plotësimin e kriterit 2.3.4 "Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht punonjësit si me poshte vijon:

➤ Të pakten 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier topograf/Gjeodet dhe 1 (një) manovrator. Punonjësit e mesiperm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë në listepagesat perkatese E-Sig per 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

Shënim: Punonjësi i kërkuar manovrator mund të disponohet edhe me kontrate noteriale, nëse nuk është pjese e stafit të OE ofertues, meqenëse edhe makineritë mund të disponohen me qira.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje per punonjesit e sipercituar: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat/certifikimet perkatese te punonjesve te mesiperm, licensen e shoqerise si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër".

Sic rezulton nga DST, në plotësimin e këtij kriterit është kusht plotësimi i formularit të vetëdeklarimit, por Referuar nenit 92, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet se:

"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit".

Sa më sipër, KSHA cmon se ky gabim nuk cënon thelbin dhe konsiderohet si devijim i vogël.

Referuar pikës 1, të nenit 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.”

KSHA, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur si dhe në zbatim të dispozitave të sipërcituara, vlerëson se operatori ekonomik përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarte të tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional.

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se OE ankimues “G.A.C” sh.p.k. ka pasur në dispozicion punonjës të kërkuar manovrator, të disponuar me kontratë noteriale dhe të ngarkuar në SPE, ndërkohë që mospërfshirja e punonjësit në formularin e vetëdeklarimit, përben një mospërputhje formale, e cila nuk cenon thelbin e ofertës dhe nuk ndikon në përmbushjen e kriterit të kualifikimit.

Sa më sipër, në rastin konkret jemi përpara një devijimi të vogël, i cili nuk përben kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik, pretendimet e OE ankimues janë të mbështetura në ligjin e prokurimit publik në fuqi, mbi bazën e të cilit është publikuar dhe zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, dhe për rrjedhojë KSHA çmon se ankesa duhet të pranohet dhe oferta e OE ankimues të kualifikohet.

Si përfundim, gjykojmë se ankesa e paraqitur duhet pranuar plotësisht.

Përsa parashtruar më sipër, mbështetur në pikën 3/a, të nenit 114, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pikën 1/a, të nenit 102, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës së paraqitur nga OE “G.A.C” sh.p.k.
2. Dërgimin e vendimit të arsyetuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe OE “G.A.C” sh.p.k.
3. Heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, sipas legjislacionit në fuqi.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK, mbi kundërshtimi e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G .A .C” Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G & M CONSTRUCTION 07” Shpk, operatori ekonomik “HTM” SHPK, operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK dhe operatori ekonomik “MANE/S” SHPK, të cilët pretendohet se, nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim, sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 750/3 prot., datë 28.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 224/3 prot., datë 02.02.2026, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK.

III.1.2. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK, duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]

❖ **Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave arsyeton si më poshtë:**

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në lidhje me pretendimet e mësipërme të OE ankimues, iu referua ankesës së operatorit ekonomik, dokumenteve të tenderit të hartuara nga NJP, si dhe vlerësimit të dokumenteve të tenderit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ku pasi i shqyrtoi ato me imtësi arriti në konkluzionin si më poshtë vijon:

Referuar të Nenit 82, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

- ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë." Sipas dispozitave të sipërcituara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, nëse është e nevojshme në kuadër të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur, ka të drejtën të kërkojë sqarim, për të saktësuar personelin e deklaruar për pozicionin e manovratorit, sipas kërkesës së dokumenteve standarte të tenderit.

OE ankimes "G.A.C" sh.p.k., ka ngarkuar si dokument provues kontratën e punës me Nr. 6360 Rep, Nr. 3755 Kol, datë 31.12.2025, me qëllim plotësimin e kriterit 2.3.4 "Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht punonjësit si me poshte vijon:

➤ Të pakten 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier topograf/Gjeodet dhe 1 (një) manovrator. Punonjësit e mesiperm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë në listepagesat perkatese E-Sig per 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

Shënim: Punonjësi i kërkuar manovrator mund të disponohet edhe me kontrate noteriale, nëse nuk është pjese e stafit të OE ofertues, meqenëse edhe makineritë mund të disponohen me qira.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje per punonjësit e sipercituar: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat/certifikimet perkatese te punonjësve te mesiperm, licensen e shoqerise si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër".

Sic rezulton nga DST, në plotësimin e këtij kriterit është kusht plotësimi i formularit të vetëdeklarimit, por Referuar nenit 92, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet se:

"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit".

Sa më sipër, KSHA cmon se ky gabim nuk cënon thelbin dhe konsiderohet si devijim i vogël.

Referuar pikës 1, të nenit 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.”

KSHA, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur si dhe në zbatim të dispozitave të sipërcituara, vlerëson se operatori ekonomik përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarte të tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional.

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se OE ankimues “G.A.C” sh.p.k. ka pasur në dispozicion punonjës të kërkuar manovrator, të disponuar me kontratë noteriale dhe të ngarkuar në SPE, ndërkohë që mospërfshirja e punonjësit në formularin e vetëdeklarimit, përben një mospërputhje formale, e cila nuk cenon thelbin e ofertës dhe nuk ndikon në përmbushjen e kriterit të kualifikimit.

Sa më sipër, në rastin konkret jemi përpara një devijimi të vogël, i cili nuk përben kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik, pretendimet e OE ankimues janë të mbështetura në ligjin e prokurimit publik në fuqi, mbi bazën e të cilit është publikuar dhe zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, dhe për rrjedhojë KSHA çmon se ankesa duhet të pranohet dhe oferta e OE ankimues të kualifikohet.

Si përfundim, gjykojmë se ankesa e paraqitur duhet pranuar plotësisht.

Përsa parashtruar më sipër, mbështetur në pikën 3/a, të nenit 114, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pikën 1/a, të nenit 102, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës së paraqitur nga OE “G.A.C” sh.p.k.
2. Dërgimin e vendimit të arsyetuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe OE “G.A.C” sh.p.k.
3. Heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, sipas legjislacionit në fuqi.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

Në kushtet kur nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “G.A.C” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G & M CONSTRUCTION 07” Shpk, operatori ekonomik “HTM” SHPK, operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK dhe operatori ekonomik “MANE/S” SHPK, të cilët pretendohet se, nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim, sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorëve për të cilët paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa mësipër, pretendimet e operatorit ekonomik “G.A.C” sh.p.k., mbi ofertat e shoqërive “G & M CONSTRUCTION 07” sh.p.k., “HTM” SHPK, “NDERTUESI 2000” SHPK dhe “MANE/S” sh.p.k., nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë”, me Nr. Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt "Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 750/3 prot., datë 28.01.2026, të dërguar përmes shërbimit postar, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 224/3 prot., datë 02.02.2026.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të KSHA, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

